



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria e Arsimit
Nr.07-Zyrtarisht
24.06.2022

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, neni 17, shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZIT DHE INSTITUCIONIN E ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL (IAAP). PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023

I. Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri" në Deçan

**DREJTIMI: SHKENCA NATYRORE
NXËNËS**

5x30 =150 nx.

**DREJTIMI: SHKENCA SHOQËRORE – GJUHËSORE
NXËNËS**

5x30 =150 nx.

Gjithsej: 300 nxënës

II. Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) "Tafil Kasumaj" në Deçan

**TEKNOLOGJI E INFORMATIVE
PROFILI ARSIMORE:**

TEKNIK E ELEKTORNIKËS
TEKNIK I SISTEMEVE TË TI-së

1x24 =24 nx.

2x24 =48 nx.

**MEKATRONIKË
PROFILI ARSIMOR:
MEKATRONIKË**

1x24 =24 nx.

**MAKINERI
PROFILI ARSIMORE:**

AUTOMEKANIK
INSTALUES I NGROHJES E KLIMATIZIMIT DHE UJËSJELLËSIT

1x24 =24 nx.

1x24 =24 nx.

EKONOMI

PROFILET ARSIMORE:

NËNPUNËS I KONTABILITETIT DHE TATIMEVE

1x32 =32 nx.

NËNPUNËS I MARKETINGUT DHE SHITJES

1x32 =32 nx.

HOTELJERI

PROFILET ARSIMORE:

ASISTENT HOTELI

1x24 =24 nx.

KUZHINJER

1x24 =24 nx.

SHËNDETËSI

SHENDETI DHE MIRËQENIA:

BASHKËPUNTOR PFOFESIONAL I INFERMIERISË

1x32 =32 nx.

Gjithsej: 288 nxënës

Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të Gjimnazit dhe të (IAAP), për vitin shkollor 2022/2023, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët kanë mbaruar arsimimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe shkollën teknike, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për Gjimnazin dhe IAAP për vitin shkollor 2022/2023, bëhet më datën **27, 28 dhe 29 qershor 2022** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohen duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallën në shkollat përkatëse më datën: 30.06.2022

Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (40%) 40 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (20%) 20 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (40%) 40 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 % pikë.

AFATI I ANKESAVE

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit kanë të drejtë ankese, brenda dy (2) ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve, Ankesa parashtohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkallën e dytë behën në DKA-në komunale brenda dy ditë pune, pas pranimi të përgjigjes nga shkolla.

Vërejtja: Mosparaqitja e ankesës në afatin zyrtar, në shkollën përkatëse, nënkupton humbjen e të drejtës për ankese në shkallën e dytë në Drejtorinë e Arsimit (DKA) apo në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). DKA dhe MASHT nuk i shqyrtojnë asnjë ankese nëse ajo nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës



DREJTORIA E ARSIMIT		21401	
07		26.06.22	